

Kuadri Ligjor
**DHE RREGULLATOR PËR
AKTIVITETIN FILANTROPIK
NË SHQIPËRI**

**Një Udhërrëfyes për Mbrojtjen e Aktiviteteve të
Ngritjes së Fondeve të OJF-ve nga Pastrimi i Parave
dhe Financimi i Terrorizmit**



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Ky publikim u përgatit nga *Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim* me mbështetjen e *Bashkimit Evropian* në kuadrin e projektit "Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri" dhe mbështetjen e *Human Security Collective* për zbatimin e projektit për Ballkanin Perëndimor, në kuadër të Programit Global "Lufta kundër Qarkullimit të Paligjshëm të Parasë", zbatuar nga *GIZ* dhe mbështetur financiarisht nga *Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik* dhe *Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme*.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e *Bashkimit Evropian*, *GIZ*, *Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik*, apo të *Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze*.

Përgatitur nga: Av. Ardjana Shehi

Grafika dhe Faqosja: Enxhi Rexhepi

© **Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim.** Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem rikthimi ose transmetohet, në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik apo tjetër, pa cituar **Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim.**

Qershor 2024



Implemented by



Norwegian Embassy

TABELA E PËRMBAJTJES

01

Përmbledhje Ekzekutive

02

Gjetjet kryesore

03

Rekomandime

04

**Tabela e gjetjeve mbi kuadrin ligjor të
aktivitetit filantropik**

05

**Shtojca 1: Parimet e Rregullimit dhe Vetërregullimit
Statutor të Ngritjes së Fondeve**



01

Përmbledhje
EKZEKUTIVE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti "Kuari Ligjor dhe Rregullator për Aktivitetin Filantropik në Shqipëri – Një Udhërrëfyes për Mbrojtjen e Aktiviteteve të Ngritjes së Fondeve të OJF-ve nga Pastrimi i Parave dhe Financimi i Terrorizmit" ofron një analizë të kuadrit ligjor dhe institucional mbi metodat e ngritjes së fondeve lidhur me aktivitetin filantropik, i cili kontribuon në veprimtarinë dhe qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse (OJF) në Shqipëri.

Përmes analizës së detajuar, raporti synon të ofrojë një kuptim se si ligjet dhe aktet nënligjore lidhur me aktivitetin filantropik ndikojnë në ngritjen dhe menaxhimin e fondeve për organizatat jofitimprurëse (OJF) në Shqipëri. Veçanërisht, raporti fokusohet në metodat e ngritjes së fondeve nga aktiviteti filantropik në këtë sektor.

Hulumtimi për përgatitjen e këtij raporti është kryer gjatë vitit 2023. Vlerësimi ligjor dhe institucional bazohet në legjislacionin ekzistues që është në fuqi deri në datën e publikimit të këtij raporti. Legjislacioni i referuar në këtë raport përfshin jo vetëm ligjet e miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë, por edhe legjislacionin nënligjor kryesor të lidhur me të, si Vendimet e Këshillit të Ministrave, udhëzimet e ministrave, rregulloret e autoriteteve të tjera përgjegjëse, etj.

Përmbajtja e këtij raporti përfshin gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, dhe ndjek strukturën e përmbajtjes së "Hartëzimi i Gjenerimit të të Ardhurave për OJF-të: Një Udhëzues Monitorimi për Mjedisin Mundësues mbi Aktivitetin Filantropik" përgatitur nga Qendra Evropiane për Ligjin e Organizatave Jofitimprurëse (ECNL)[1].

Raporti bazohet në Parimet Globale të Ngritjes së Fondeve[2], të cilat adresojnë 7 (shtatë) fusha kryesore:

- 1.Garancitë themelore;
- 2.Metodat e ngritjes së fondeve;
- 3.Mbrojtja e të dhënave dhe e drejta e privatësisë;
- 4.Ngritja e fondeve ndërkufitare;
- 5.Tatimi/Taksimi;
- 6.Transparenca, llogaridhënia dhe mbikëqyrja;
- 7.Regjistrimi, licensimi dhe dhënia e lejes.

[1] <https://ecnl.org/publications/mapping-fundraising-csos>

[2] Dokumenti mbi Parimet Globale të Ngritjes së Fondeve është përgatitur nga ECNL dhe përkthyer në shqip nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, i aksesueshëm online <https://ecnl.org/sites/default/files/2020-08/Fundraising-Principles-Briefer.pdf>

02

Gjettet
KRYESORE

GJETJET KRYESORE

Filantropia është angazhim vullnetar, strategjik (financiar, organizativ, burime njerëzore) me qëllim plotësimin e nevojave për një shoqëri më të drejtë dhe paqësore, pa përfitim në këmbim. Ajo ushtrohet nga individë dhe entitete private, të cilët përdorin burimet e tyre financiare dhe jofinanciare për të mirën publike. Filantropia mbështet programe në fusha të ndryshme, duke përfshirë arsimin, shëndetësinë, shkencën, mjedisin, kulturën dhe zhvillimin ndërkombëtar. Ajo zhvillohet në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, duke plotësuar nismat qeveritare dhe ato të sektorit privat. Një karakteristikë unike e filantropisë është aftësia e saj për t'iu përgjigjur në kohë reale sfidave kritike me të cilat përballen shoqëritë tona, duke pasur njëkohësisht një këndvështrim afatgjatë.

Punimi i mëposhtëm, i organizuar në formën përkatëse, synon që të japë një shpjegim të gjendjes aktuale, deri në ditën e botimit të këtij punimi, se sa gjerë dhe si legjislacioni shqiptar mbulon me dispozita ligjore aktivitetin filantropik. Disa nga gjetjet kryesore të prezantuara në raport janë:

- Në Shqipëri nuk kemi një legjislacion të veçantë, përmbajtja dhe dispozitat ligjore të të cilit të parashikojnë në mënyrë të posaçme aktivitetin filantropik. Por, duhet të theksohet se në akte ligjore dhe nënligjore të tjera, kemi dispozita e rregullime ligjore në lidhje me ndihmën për veprimtarinë me natyrë bamirëse e humanitare.
- Kodi Civil dhe Ligji për Organizatat Jofitimprurëse (OJF-të) parashikojnë përkufizime të termit “dhurim” për dhe në përfitim të OJF-ve dhe individëve në nevojë.
- Marrëveshjet që pesë komunitetet fetare kanë nënshkruar me shtetin shqiptar, si dhe Ligji për Kryqin e Kuq Shqiptar, përmbajnë pak dispozita në lidhje me filantropinë dhe ngritjen e fondeve, si dhe mbi tatimet dhe detyrimet e tjera përkatëse ndaj shtetit, si ato doganore, etj., nga të cilat përjashtohen këto komunitete për përfshirjen e tyre në veprimtari filantropike.
- Është identifikuar se nuk ka rregullime dhe dispozita ligjore të posaçme të cilat ndihmojnë në organizimin e aktiviteteve për mbledhjen e fondeve në shkallë të gjerë publike. Kjo përcaktohet në dispozitat e Ligjit për Kryqin e Kuq Shqiptar dhe marrëveshjet me komunitetet fetare, por këto dispozita mbeten të zbatueshme vetëm për këto të fundit.
- Është identifikuar se nuk ka dispozita rregullatore të posaçme të shprehura për licenca, leje, etj., për aktivitetet për ngritjen e fondeve.
- Ligji për Mediat Audiovizive siguron që koha televizive duhet të vihet në dispozicion për teleshikuesit kur informacioni i transmetuar ka qëllime humanitare, rast fatkeqësie, etj.



- Legjislacioni parashikon se OJF-të duhet të ruajnë privatësinë e dhuruesve nga publiku, por jo nga shteti. Kjo ndodh për shkak të kontrollit detyrues që shteti ka mbi OJF-të dhe mbi dhuruesit në mënyrë që shteti të sigurohet që dhurimet nuk janë përfshirë në skema që kanë të bëjnë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit; kur dyshohet një veprim i tillë, organet tatimore, të cilët kanë detyrën funksionale ligjore të kontrollojnë OJF-të edhe në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, drejtohen tek Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) për kontroll të thelluar nëse dhuruesi është pjesë e ndonjë veprimtarie të paligjshme.
- Në këtë përmbledhje vihet re se legjislacioni tatimor, pavarësisht se nuk ka një përkufizim të shprehur të posaçëm të termave "dhurim", "filantropi", "donacion", ka dispozita ligjore të cilat i referohen këtyre të fundit. Në veçanti, Ligji mbi TVSH-në dhe Ligji i Tatimit mbi të Ardhurat parashikojnë përjashtime nga tatimet përkatëse për dhurimet të cilat kanë natyrë bamirëse dhe humanitare. Bazuar në Ligjin për OJF-të, dhurimet për OJF-të për veprimtarinë jofitimprurëse joekonomike nuk janë subjekt tatimi.
- Ndërkohë, OJF-të që shesin mallra që janë financuar nga dhurimet janë subjekt tatimi, përveçse kur mallrat e shitura janë të përjashtuara shprehimisht nga tatimi dhe kur fitimi nga shitja e këtyre mallrave përdoret për të mbështetur aktivitetin joekonomik të OJF-ve.
- Ligje të tjera, si Ligji për Sponsorizimet, legjislacioni doganor dhe për lojërat e fatit, parashikojnë dispozita ligjore në lidhje me tatimin apo taksimin dhe ngarkimin me detyrime doganore ndaj shtetit të shoqërive tregtare, të cilët janë dhurues të mallrave të cilat përbëjnë dhurime, të mallrave që futen në territorin shqiptar dhe që shërbejnë për qëllime humanitare, apo edhe për llotaritë me qëllime bamirëse dhe aktivitete që kanë të bëjnë me mbledhje fondesh.
- Legjislacioni shqiptar nuk ka dispozita të shprehura sa i përket dhurimeve me para elektronike (e-money), por, dhurimet me para elektronike janë subjekt tatimi si çdo dhurim tjetër. Po kështu, është konstatuar gjithashtu një mungesë e dispozitave ligjore të posaçme që kanë të bëjë me kartat SIM, të cilat mund të përdoren nga OJF-të. Gjithashtu, nuk është parashikuar shprehimisht në legjislacionin përkatës nëse individët që kanë në përdorim kartat SIM dhe të cilët i përdorin ato për qëllime bamirëse, nuk i nënshtrohen tatimeve.

Tabela më poshtë në këtë punim synon të fotografojë legjislacionin përkatës në fuqi në Shqipëri në lidhje me filantropinë, duke u fokusuar në çështje përkatëse themelore, si garantitë bazë dhe aspekte të ngjashme, metodat e lejuara të ngritjes së fondeve, mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti i dhuruesve, regjimi tatimor në fuqi, transparenca, llogaridhënia dhe mbikqyrja, si dhe aspekte të tjera rregullatore. Të dhënat e paraqitura përmes tabelës ofrojnë mundësinë e njohjes me gjetje të tjera në lidhje me legjislacionin në fuqi për filantropinë. Edhe gjatë paraqitjes së rekomandimeve të mëposhtme, janë shkruar disa gjetje të rëndësishme të cilat janë përdorur si bazë për rekomandimet përkatëse.

Rekomandime

REKOMANDIME

- Rekomandohet që të kryhet zhvillim i legjislacionit (përmirësim me ndryshime ligjore dhe/apo miratim të dispozitave ligjore të reja ose akteve të posaçme) në lidhje me filantropinë. Në Shqipëri, filantropia, si një aktivitet i cili synon që të përmirësojë jetën e një pjese të caktuar të popullsisë apo të ndihmojë në përmbushjen e qëllimeve humanitare, bamirëse e më tej, nuk gjen një rregullim ligjor të posaçëm. Dispozitat ligjore përkatëse i identifikojmë në ligje të ndryshme, por jo në një ligj të vetëm të posaçëm. Shteti duhet të marrë nismat e duhura legjislative që të miratojë ligj/e të posaçëm/me, objekti dhe qëllimi i të cilit/ave duhet të jetë filantropia, ose të bëjë rregullime ligjore të shprehura dhe më përfshirëse dhe integruese të dispozitave ligjore aktuale.
- Ligji për TVSH-në përmban dispozita ligjore ku përmendet 'organizata filantropike', ndërkohë që nuk parashikon një përkufizim të organizatës filantropike. Në të njëjtën kohë, nuk kemi asnjë ligj apo akt nëligjor të cilët parashikojnë këtë përkufizim. Në këto kushte, duhet që në mënyrë të posaçme të parashikohet përkufizimi gjithëpërfshirës i organizatës filantropike dhe i aktivitetit filantropik.
- Rekomandohet që legjislacioni i posaçëm për filantropinë të parashikojë parime e standarde në lidhje me transparencën, llogaridhënien, mbikëqyrjen dhe aspekte të tjera të lidhura me dhurimet dhe kontributet filantropike si në legjislacionet më të zhvilluara në këtë fushë. Rekomandohet gjithashtu, të bëhet rregullim ligjor i shprehur, edhe me ligj të veçantë, për dhurimet me para në dorë (cash) dhe 'crowdfunding' në kushtet kur praktikat e deritanishme përkatëse janë krijuar bazuar në parimin që legjislacioni nuk i ndalon shprehimisht. Neni 37 i Ligjit për OJF-të parashikon "Organizatat jofitimprurëse kanë të drejtë të kryejnë veprimtari për mbledhjen e fondeve, për t'i përdorur për përmbushjen e qëllimeve dhe objektit të veprimtarisë së tyre ose për të mbështetur qëllimet dhe veprimtaritë e organizatave të tjera jofitimprurëse. Rregullat për mbledhjen publike të fondeve përcaktohen me ligj të veçantë".
- Rekomandohet të bëhen rregullimet e duhura ligjore në mënyrë që individët dhe subjektet tregtare, etj., të kenë mundësinë ligjore të dhurojnë nëpërmjet platformave online, në kufijtë përkatës të parashikuar nga ligji për mbajtjen dhe veprimet juridike me para në dorë (kur dhurimet bëhen me para në dorë dhe jo me rrugë bankare apo mjete të tjera që barazohen me rrugën bankare). Gjithashtu, do t'i shërbente edhe organizatave të ndryshme të cilat kanë qëllime filantropike, të kishin mundësinë ligjore dhe informacion në lidhje me mënyrën se si mund të krijohen platforma që pranojnë dhurime përmes 'crowdfunding' në rrugën e duhur ligjore.



- Siç është përmendur edhe më lart, nuk ka rregulla dhe dispozita ligjore të posaçme të cilat ndihmojnë në organizimin e aktiviteteve për mbledhjen e fondeve në shkallë të gjerë publike. Kjo gjë përcaktohet në dispozitat e ligjit për Kryqin e Kuq Shqiptar dhe marrëveshjet me komunitetet fetare, por këto dispozita mbeten të zbatueshme vetëm për këto të fundit. Si rrjedhojë, një rregullim më specifik do të ndihmonte dhe do të kontrollonte edhe aktivitetet e tjera të mbledhje së fondeve, të cilat kanë qëllime bamirëse. Dispozitat duhet t'i referohen jo vetëm Kryqit të Kuq dhe komuniteteve fetare, por edhe OJF-ve, organizatave të tjera, si dhe aktiviteteve të organizuara nga organe/individë, të cilët duan që fitimet e mbledhura t'i përdorin për të mbështetur qëllime jofitimprurëse.
- Rekomandohet të parashikohen dispozita ligjore të shprehura në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit të dhurimeve dhe kontributeve filantropike dhe të dhënave personale të dhuruesve, të cilat mund të publikohen vetëm me pëlqimin e shprehur me shkrim të tyre.
- Ndryshime duhet të bëhen edhe në Ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat, ku kontributi filantropik, i çfarëdo natyre qoftë (në para, shërbime, natyrë, kontribute të paprekshme) të konsiderohet si shpenzim i zbritshëm për qëllime të tatimit përkatës mbi të ardhurat përkatëse, jo vetëm për subjektet tregtare (shoqëritë tregtare, etj.), por edhe për individët.




Tabela e
GJETJEVE

Tabela e gjetjeve mbi kuadrin ligjor të aktivitetit filantropik

PARIMET	PYETJE MBI KUADRIN LIGJOR	ALBANIAN LEGISLATION
<p>GARANCITË</p> <p>THEMELORE DHE</p> <p>ÇËSHTJE TË</p> <p>PËRGJITHSHME</p>	<p>1. A ofron legjislacioni garanci themelore për OJF-të që të kenë akses në burime, duke përfshirë të ardhurat nga përpjekjet filantropike?</p> <p>2. A i lejon legjislacioni OJF-të të mbledhin fonde për qëllime legjitime jofitimprurëse?</p> <p>3. Si e përkufizojnë Kodi Civil dhe/ose Kodi Tatimor "dhurimin" dhe "sponsorizimin"?</p>	<p>1. Legjislacioni shqiptar^[3] parashikon rregullime përsa i përket aksesit të OJF-ve në burime dhe të ardhura që kanë natyrë filantropike.</p> <p>2. OJF-të kanë të drejtë të mbledhin fonde për qëllime legjitime të interesit publik të cilat nuk kanë si qëllim përfitimin vetjak apo shpërndarjen e të ardhurave tek themeluesit, drejtuesit e organizatës apo te anëtarët e organizatës, me përjashtim të ndihmës ndaj këtyre të fundit kur konsiderohen si individë në nevojë^[4].</p> <p>3. Në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë^[5], parashikohet ky përkufizim mbi dhurimet: "Neni 761: Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon palës tjetër në pronësi, pa shpërblim, një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat kjo i pranon". Në Kodin Civil nuk ka një përkufizim për sponsorizimet. Përsa i përket legjislacionit tatimor^[6], nuk ka një përkufizim të posaçëm të termit "dhurim" për OJF-të. Gjithashtu, ka një mungesë përkufizimi të termit "sponsorizim". Ligji për OJF-të, Neni 2, pika 8, përkufizon Donacionin / Dhurimet si më poshtë: "Dhurim" ose "donacion" është ofrimi i fondeve ose bazës materiale përmes një kontrate ose marrëveshje për të mbështetur realizimin e qëllimit të organizatës jofitimprurëse.</p>

[3] Ligji Nr.8788, datë 7.5.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", Neni 35 "Burimet dhe përdorimi i të ardhurave: "Burimet e të ardhurave të organizatës jofitimprurëse janë të ardhurat nga kuotizacioni kur ka të tilla, fonde, grante dhe donacionet e ofruara nga subjektet private ose publike, vendas ose të huaj, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të organizatës jofitimprurëse. Organizatat jofitimprurëse sigurojnë të ardhura nga burime që njihen nga ky ligj dhe bëjnë shpenzime vetëm për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë, për të cilin janë krijuar, si dhe për drejtimin e mirëmbajtjen e pasurisë së tyre.

[4] Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e organizatës jofitimprurëse prej personave që janë subjekte të statutit ose aktit themelues, përveç detyrimeve në formën e pagave, rrogave, pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të organizatës jofitimprurëse. Shoqatat, në raste të veçanta, mund t'u japin ndihmë financiare anëtarëve të saj, personave të jashtëm ose subjekteve të tjera. Shoqatat mund të japin ndihma të tilla edhe nga fonde të dhuruara ose të vëna në dispozicion, kur donatorët kanë përcaktuar shprehimisht një të drejtë të tillë.

[5] Ligj Nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin Nr.8536, datë 18.10.1999, Ligjin Nr.8781, datë 3.5.2001, Ligjin Nr.17/2012, datë 16.2.2012, Ligjin Nr.121/2013, datë 18.4.2013, dhe Ligjin Nr.113/2016, datë 3.11.2016.

[6] Ligj Nr.9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

<p>METODAT E MBLEDHJES SË FONDEVE</p>	<p>PYETJE TË PËRGJITHSHME PËR MËNYRAT E PAGESËS</p>	<p>1. A i lejon dhe i inkurajon legjislacioni OJF-të që të përdorin një gamë të gjerë metodash për ngritjen e fondeve, duke përfshirë teknologjitë digjitale (p.sh., crowdfunding, dhurime përmes SMS/telefonata bamirësie, dhurim përmes kartave të kreditit, etj.)?</p> <p>2. A janë rregulloret, që ndikojnë në metodat e ngritjes së fondeve, të formuluar në mënyrë të qartë, tërësisht të nevojshme dhe proporcionale?</p> <p>3. A lejohet/nuk pengohet me ligj dhurimi anonim?</p> <p>4. Cilat ligje/rregullore rregullojnë dhurimet në para elektronike (e-money) dhe a njihen ato si një sistem zyrtar pagesash në kuadrin ligjor?</p>	<p>1. Legjislacioni shqiptar nuk kufizon shprehimisht përdorimin e gjerë të metodave të ngritjes së fondeve. Legjislacioni nuk parashikon shprehimisht mbi ngritjen e fondeve nëpërmjet teknologjive digjitale, por edhe nuk e ndalon shprehimisht atë.</p> <p>2. Nuk ka akte ligjore dhe nënligjore të posaçme për ngritjen e fondeve dhe nuk ka rregulla apo dispozita ligjore të posaçme dhe të qarta për metodat e ngritjes së fondeve.</p> <p>3. Nuk ka dispozita ligjore të posaçme për të rregulluar dhurimet anonime (legjislacioni në fuqi të orienton për dhurime anonime për publikun, por jo anonime për organet shtetërore). Megjithatë, bazuar në legjislacionin bankar, çdo dhurim i realizuar duke përdorur shërbimet bankare duhet të identifikojë dhuruesin dhe burimin e të ardhurave. Po kështu, edhe legjislacioni tatimor lidhur me detyrat e organeve tatimore për kontrollin e OJF-ve për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit detyron OJF-të të identifikojnë dhe të mbajnë dokumentacion lidhur me çdo financim apo dhurim për OJF-të, përfshirë edhe ato të bëra në para në dorë (cash).</p> <p>4. Nuk ka legjislacion të shprehur për dhurimet me para elektronike. Megjithatë, paraja elektronike njihet si mjet pagese për qëllime të tjera[7].</p>
--	--	---	--

[7] Vendim i Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë Nr.59, datë 24.11.2021 "Për miratimin e Rregullores "Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë Elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimit të pagesave".

<p>METODAT E MBLEDHJES SË FONDEVE</p>		<p>5. A i nënshtrohet TVSH-së apo ndonjë takse tjetër transferimi i dhurimeve nëpërmjet parasë elektronike?</p>	<p>5. Bazuar në Ligjin për OJF-të, dhurimet për OJF-të për veprimtarinë jofitimprurëse joekonomike nuk janë subjekt tatimi. Ligji për Tatimin mbi të Ardhurat parashikon: Nuk janë subjekt i tatim fitimit korporativ "...ç) entitetet që ushtrojnë vetëm veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor apo edukativ, pasuria apo fitimi i të cilëve nuk përdoret për përfitimin e organizuesve apo anëtarëve të tyre;..."[8]. Dhurimet, pavarësisht mënyrës së pagesës së tyre, janë subjekt i të njëjtave rregulla për qëllime identifikimi dhe i të njëjtit regjim tatimor (ky i fundit nëse i zbatueshëm). Dhurimet nuk janë subjekt i ndonjë tatimi të veçantë vetëm për shkak se jepen / dhurohen nëpërmjet parasë elektronike. Dhurimet nëpërmjet parasë elektronike janë subjekt tatimi (nuk ka tatim të posaçëm për dhurimet përmes parasë elektronike). Nëse zbatohet tatim për dhurimet e tjera do të zbatohet edhe për dhurimet me para elektronike, si çdo dhurim tjetër.</p>
<p>METODAT E MBLEDHJES SË FONDEVE</p>	<p>DHURIMET PËRMES SMS-VE DHE TELEFONATAVE</p>	<p>1. A ka ligje dhe/ose rregullore që përshkruajnë rregulla për dhurimet nëpërmjet SMSve dhe telefonatave dhe për caktimin e numrave për qëllime bamirësie?</p> <p>2. A ka ndonjë numër telefoni të caktuar me ligj/rregullore për organizata të veçanta (p.sh., organizata humanitare etj.)?</p> <p>3. A përjashtohet nga TVSH-ja SMS/telefonata?</p>	<p>1. Ka akte nënligjore[9] që përcaktojnë rregulla për SMS, përfshirë edhe për mesazhe të dërguara / marra nga shoqatat, por jo në mënyrë të shprehur në lidhje me SMS, bërjen e telefonatave dhe me dedikimin e numrave të veçantë për qëllime bamirësie.</p> <p>2. Nuk ka numra telefoni të caktuar me ligj[10] dhe të dedikuara për organizata humanitare, etj.</p> <p>3. Dërgimi i SMS / telefonatave, pavarësisht qëllimit, nuk është i përjashtuar nga TVSH.</p>

[8] Neni 27/2/ç i Ligjit Nr. 29/2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar.

[9] Udhëzim i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr.6, datë 28.05.2010 "Mbi Përdorimin Korrekt të SMS-ve për Qëllime Promocionale, Reklama, Informacione, Shitjeve Direkte, nëpërmjet Telefonisë Celulare": ... 11. Në rastet e mesazheve (sms) të dërguara nga shoqata, organizma politike ose nga të tretë, anëtarëve të tyre, përveç pëlqimit të nevojshëm me shkrim, duhet të zbatohen kushtet dhe kriteret ligjore për të dhënat sensitive në përputhje me nenin 7 të ligjit 9887 datë 10.03.2008 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i përditësuar. 13. Operatorët e shërbimeve të telekomunikacionit dhe subjektet e tjera, në rastet e dërgimit të mesazheve (sms) të reklamave, duhet që nga subjektet e të dhënave të marrin pëlqimin specifik. Shfaqja e vullnetit dhe pëlqimi specifik duhet të shprehë qartë tipologjinë e mesazheve (sms) të reklamave që mund të dërgohen në përputhje me nenin 6 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008. <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2010/05/28/6/c5f0e702-1b04-4e1f-81d4-3cb29e3f9fe2>.

[10] Ligj Nr.9918, datë 19.5.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me Ligjin Nr.102/2012, datë 24.10.2012, Ligjin Nr.107/2018, datë 20.12.2018; Ligjin Nr.92/2019, datë 18.12.2019.

<p>METODAT E MBLEDHJES SË FONDEVE</p>		<p>1. A ka ndonjë ligj/rregullore për dhurimet nga crowdfunding?</p>	<p>1. Nuk ka ligje apo akte nënligjore të posaçme që përcaktojnë shprehimisht në lidhje me dhurimet nga crowdfunding përveç dispozitës ligjore orientuese në nenin 37 të Ligjit për OJF (mbledhje publike të fondeve[11]), por as edhe ndalim të shprehur ligjor.</p> <p>Në Shqipëri platforma Smile.al, e krijuar nga Banka Credins dhe zbatuar nga Fondacioni Credins, mund të konsiderohet si një e tillë. Kjo platformë ka një faqe online, e cila përdoret si aplikacion për të mbledhur dhurime online për projektet e OJFve. Është me vend të hamendësohet se krijimi i saj është mbështetur në Ligjin 107/2015[12], Ligjin 8788/2001[13] dhe Ligjin 9880/2008[14].</p> <p>Ligji për Kryqin e Kuq parashikon për mbledhje të fondeve, përfshirë mbledhjen publike të fondeve dhe evente për ngritjen e fondeve[15].</p>
<p>MBLEDHJA E FONDEVE PËRMES FAQES SË INTERNETIT</p>		<p>1. Cilat ligje dhe/ose udhëzime rregullojnë sistemet e pagesave, shërbimet e pagesave dhe instrumentet e bazuara në karta?</p>	<p>1. Ligjet e mëposhtme bëjnë rregullimin e sistemit të pagesave dhe të shërbimit të pagesave: (1) Ligji Nr. 55/2020 "Për Shërbimet e Pagesave". Qëllimi i Ligjit është krijimi i kuadrit ligjor për shërbimet e pagesave në Republikën e Shqipërisë. Objekti i Ligjit është përcaktimi i kushteve dhe i rregullave për krijimin, licensimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave; transparencën e kushteve dhe kërkesat për informim për shërbimet e pagesave; të drejtat e detyrimet përkatëse të përdoruesve dhe të ofruesve të shërbimeve të pagesave lidhur me ofrimin e shërbimeve të pagesave si një veprimtari e vazhdueshme ose aktivitet tregtar. (2) Ligji Nr.133/2013 "Për Sistemin e Pagesave". Qëllimi i Ligjit konsiston në nxitjen e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit kombëtar të</p>

[11] Neni 37 paragrafi i dytë i Ligjit Nr.8788 datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar.

[12] Ligji Nr.107/2015 "Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara", ndryshuar me Ligjin Nr.123/2016, datë 15.12.2016.

[13] Ligji Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse"

[14] Ligji Nr.9880, datë 25.02.2008 "Për Nënshkrimin Elektronik", ndryshuar me Ligjin Nr.8, datë 30.09.2009, Ligjin Nr.122/2016 dhe Ligjin 18 datë 9.12.2022.

[15] Ligji Nr.7864, datë 29.09.1994 "Për Kryqin e Kuq", i ndryshuar Ligjin nr.17/2021, datë 8.2.2021 (Nenet 1, 6, 8).

<p>MBLEDHJA E FONDEVE PËRMES FAQES SË INTERNETIT</p>			<p>pagesave në Shqipëri. Objekti i ligjit është përcaktimi i parimeve bazë që kanë të bëjnë me licensimin, rregullimin, mbikëqyrjen e elementëve të rëndësishëm të sistemit kombëtar të pagesave, si dhe përcakton rregullat për mbrojtjen e sistemeve. Dispozitat e këtij ligji rregullojnë edhe marrëveshjet e kolateralit financiar.</p>
<p>MBLEDHJA E FONDEVE PËRMES FAQES SË INTERNETIT</p>	<p>LLOTARITË DHE LOJRAT E FATIT</p>	<p>1. Cilat ligje dhe/ose udhëzime rregullojnë llotaritë dhe a lejohen OJF-të të organizojnë aktivitete të tilla (apo shteti ka të drejta ekskluzive)?</p> <p>2. A ka rregulla dhe përjashtime specifike për lotaritë bamirëse dhe eventet për ngritjen e fondeve?</p>	<p>1. Ligji i cili parashikon mënyrën se si funksionojnë dhe operojnë lojërat e fatit në Shqipëri është Ligji Nr. 155/2015 "Për Lojërat e Fatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar[16]. Bazuar në këtë ligj, të drejtën për të zhvilluar aktivitete në veprimtari që lidhen me lojrat e fatit, ku përfshihet edhe Lotaria Kombëtare, nuk e ka vetëm shteti por edhe shoqëritë (interpretohet shoqëritë tregtare, pra, nuk përfshihen OJF-të) që janë të interesuara.</p> <p>2. Ligji Nr. 155/2015 "Për Lojërat e Fatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar ka karakter të përgjithshëm dhe nuk ka rregulla dhe përjashtime specifike të shprehura në lidhje me lotaritë e përdorura për qëllime bamirësie dhe në lidhje me aktivitetet e ngritjes së fondeve. Ligji për Lotarinë Kombëtare[17] parashikon për detyrimin e shoqërisë operatore përkatëse për të dhuruar 2.2% të qarkullimit vjetor për interes publik (interpretohet përfshirë edhe për OJF-të) dhe për transparencën e përdorimit të fondit të kaluar tek shteti për këtë qëllim.</p>
<p>MBLEDHJA E FONDEVE PËRMES FAQES SË INTERNETIT</p>	<p>KUTITË E DHURIMIT TË PARASË NË DORË DHE METODAT E TJERA TË DHURIMIT TË PARASË NE DORË (NË RRUGË, ETJ.)</p>	<p>1. A ka ndonjë ligj që rregullon kushtet për organizimin e dhurimit të parasë në dorë (p.sh., përmes kutive të parasë në dorë??). A ka rregulla për mbledhjen e parasë në dorë në rrugë apo derë më derë?</p>	<p>1. Nuk ka rregulla të posaçme të parashikuara në ligje apo akte nënligjore në lidhje me mbledhjen e parasë në dorë në asnjë lloj forme (para në dorë apo kuti e parasë në dorë, në rrugë, derë më derë, etj.).</p>

[16] Ligji Nr. 155/2015 PËR LOJËRAT E FATIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË (ndryshuar me ligjin nr. 140/2016, datë 22.12.2016, nr. 75/2018, datë 25.10.2018) (i përditësuar)

[17] Ligji Nr.95/2013 Për Miratimin e Marrëveshjes së Licencës Për Lotarinë Kombëtare Ndërmjet Ministrisë së Financave, si Autoritet i Autorizuar, dhe Shoqërisë "Oesterreichische Lotterien", Gmbh, nëpërmjet Shoqërisë "Olg Project" Shpk

<p>MBLEDHJA E FONDEVE PËRMES FAQES SË INTERNETIT</p>	<p>KUTITË E DHURIMIT TË PARASË NË DORË DHE METODAT E TJERA TË DHURIMIT TË PARASË NE DORË (NË RRUGË, ETJ.)</p>	<p>2. Cilat janë rregullat për dhënien e faturave për transaksionet në para në dorë dhe a vlen kjo për dhurimet me para në dorë ?</p> <p>3. A ka ndonjë kufizim për sasinë e parave në dorë që një OJF mund të marrë nga një dhurues i vetëm?</p>	<p>2. Nëse kryhen dhurime në para në dorë ato duhet të kufizohen në shumat e përcaktuara në Ligjin për Procedurat Tatimore dhe, nëse dhurimet janë brenda këtyre kufijve (lutem shih pika 3 me poshtë), duhet të shoqërohen me lëshimin e faturës tatimore / kuponit tatimor nga marrësi i dhurimit (OJF).</p> <p>3. Pavarësisht se nuk shkruhet shprehimisht, interpretohet se dhurimet me para në dorë janë subjekt i kufizimeve ligjore në lidhje me shumat në para në dorë. Ligji për Procedurat Tatimore[18]parashikon si më poshtë: Neni 59/1 "Tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, nuk mund të kryejnë ndërmjet tyre transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë, kur vlera e transaksionit është më e madhe se 150,000 lekë". Edhe OJF-të duhet të zbatojnë këtë detyrim.</p>
<p>MBLEDHJA E FONDEVE PËRMES FAQES SË INTERNETIT</p>	<p>EVENTET PËR NGRITJEN E FONDEVE[19]</p>	<p>1. A ka rregulla specifike të zbatueshme mbi eventet për ngritjen e fondeve?</p>	<p>1. Nuk ka rregullime të posaçme për aktivitetet e ngritjes së fondeve nga OJF-të. Pa kundërshtuar këtë, Ligji për Kryqin e Kuq Shqiptar[20] dhe marrëveshjet me pesë[21] komunitetet fetare[22] (të miratuara me ligj), kanë disa dispozita ligjore të veçuara në lidhje me aktivitetet e ngritjes së fondeve (dispozitat e këtyre të fundit përmbajnë rregullime në lidhje me përjashtimin</p>

[18] Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

[19] Event i organizuar për të rritur ndërgjegjësimin, mbështetjen dhe fonde për një bamirësi, si koncerte, darka, etj.

[20] <https://www.kksh.org.al/wp-content/uploads/2015/04/STATUTI-I-KRYQIT-TE-KUQ-SHQIPTAR-2008.pdf>

<https://qbz.gov.al/eli/ligj/1994/09/29/7864/3102fd59-f42f-4169-bc18-34088f020b5e>

[21] Ligji Nr.10056, datë 22.1.2009 "Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetet Mysliman të Shqipërisë për Rregullimin e Marrëdhënieve të Ndërsjellta"; Ligji Nr.10057, datë 22.01.2009 Për Ratifikimin e "Marrëveshjes Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për Rregullimin e Marrëdhënieve të Ndërsjellta"; Ligji Nr.10394, datë 10.3.2011 Për Ratifikimin e "Marrëveshjes Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkësisë Fetare "Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë" për Rregullimin e Marrëdhënieve të Ndërsjellta"; Ligji Nr.8902, datë 23.05.2002 Për Ratifikimin e e "Marrëveshjes Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për Rregullimin e Marrëdhënieve të Ndërsjellta"; Ligji Nr.10058, datë 22.01.2009 Për Ratifikimin e "Marrëveshjes Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshitës Botërore Bektashiane për Rregullimin e Marrëdhënieve të Ndërsjellta".

[22] Ligji Nr.10056, datë 22.1.2009 "Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetet Mysliman të Shqipërisë për Rregullimin e Marrëdhënieve të Ndërsjellta", Neni 12 'Marrëdhëniet me bashkësitë e huaja fetare': "...2. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka të drejtë të përfitojë mbështetje financiare dhe/ose materiale nga entitete dhe/ose individë të huaj, për aq sa kjo mbështetje nuk bie ndesh me këtë Marrëveshje dhe me legjislacionin në fuqi".

<p>MBLEDHJA E FONDEVE PËRMES FAQES SË INTERNETIT</p>		<p>2. A i nënshtrohen tatimit kostot e argëtimit apo "shpenzimet e përfaqësimit"?</p> <p>3. A ka rregullime ligjore ose tatim/taksa të ndryshme (TVSH) nëse OJF-të e kontraktajnë shitjen e biletave palëve të treta?</p>	<p>ngatim/taksa[23] dhe rregullimin e veprimtarisë së tyre në aktivitete që nuk kanë qëllim fitimin[24] duke lënë një vend të vogël për dispozitat në lidhje me mënyrën dhe aktivitetet për mbledhjen e fondeve[25]). Por, këto dispozita janë të zbatueshme vetëm për Kryqin e Kuq dhe komunitetet përkatëse fetare, siç parashikohen në ligjet përkatëse.</p> <p>2. Neni 9 i Ligjit për Kryqin e Kuq Shqiptar parashikon se Kryqi i Kuq Shqiptar përjashtohet nga pagimi i çdo lloj tatimi e takse. Dispozita ligjore shpreh qartë përjashtimin nga pagesa e çdo tatimi të Kryqit të Kuq. Ligji për Sponsorizimet parashikon mbi sponsorizimin për qëllime publike dhe Ligji për Tatimin mbi të Ardhurat parashikon për konsiderimin e shumave të sponsorizuara deri në një përqindje të caktuar si shpenzime të zbritshme për qëllime tatimore (tatim fitimi për subjektet tregtare).</p> <p>3. Shitja e biletave konsiderohet si veprimtari ekonomike jofitimprurëse. Organizata ka detyrimin të lëshojë kuponë fiskalë[26] ose fatura fiskale. Pavarësisht sa më sipër, çdo shërbim dhe shitje e produkteve që lidhen me</p>
---	--	---	---

[23] Ligji Nr. 10057, datë 22.01.2009 Për Ratifikimin e "Marrëveshjes Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për Rregullimin e Marrëdhënieve të Ndërsjellta", Neni 15 'Statusi juridik dhe fiskal': "... 2. Përjashtohen nga të gjitha llojet e taksave: a) Subvencionet financiare të çfarëdo lloji dhe çdo e ardhur tjetër e ligjshme, si edhe donacionet materiale të destinuara për të realizuar misionin e vet, kur këto të ardhura apo donacione nuk përdoren për përfitime nga organizatorët. b) Ndërtimi i objekteve të reja, ndërtesat në pronësi apo në përdorim të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, ose të personave juridikë të themeluar prej saj të regjistruara pranë organeve kompetente shtetërore, në rastet kur ato përdoren pa qëllim fitimi për ushtrimin e besimit, drejtimin dhe administrimin kishtar, veprimtarinë baritore, humanitare e bamirëse, formimin e klerikëve, mësimin e teologjisë dhe shkencave të tjera kishtare, si dhe të personelit fetar dhe laik në shërbim të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. c) taksa e trashëgimisë ose e kalimit të pasurisë në procesin e regjistrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat i dhurohen Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë ose kur ato kalojnë mes entiteteve të vetë Kishës.... 6. Për veprimtaritë me karakter institucional, si: ushtrimi i kultit, drejtimi dhe administrimi kishtar, veprimtaria baritore, humanitare dhe bamirëse, formimi i klerit, mësimi i teologjisë dhe i shkencave fetare, kisha dhe personat juridikë të themeluar prej saj nuk janë të detyruar të mbajnë regjistër kontabël dhe t'u nënshtrohen standardeve administrative të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë çështje. Si pasojë, për të tilla veprimtari ato nuk e kanë detyrim që të paraqesin bilancin kontabël vjetor tek organet kompetente shtetërore dhe as ta depozitojnë atë pranë organizmave shtetërore të caktuar nga legjislati në fuqi".

[24] Ligji për Kryqin e Kuq Shqiptar, Neni 40 'Të ardhurat': "Të ardhurat vjetore të KKS-së përbëhen nga: - kuotizacionet; - burime të siguruara nga veprimtaritë ekonomike për realizimin e objektivave të tij humanitare; - burime të ndryshme, trashëgimi, etj.; - subvencione të shtetit ose nga shoqëri të tjera publike; - burime të krijuara me autorizimin e pushteteve publike (p.sh. mbledhje ndihmesh, festa në sheshe publike etj)."

[25] Ligji për Kryqin e Kuq Shqiptar, Neni 37 'Të përgjithshme': "KKS për të zhvilluar veprimtarinë e vet humanitare në kufijtë që i ka caktuar vetes, pranon, shet, zotëron, tjetëron dhe administron, çdo pasuri dhe mjet që i nevojitet. KKS mund të pranojë kontribute të pakufizuara dhe ndihma të çdo forme nga individë, autoritete dhe organizma private. Mund të pranojë donacione anonime deri në shifrën 1.000.000 lekë. Nuk mund të pranojë donacione që vijnë direkt nga të ardhura të veprimtarive që bien në kundërshtim me Parimet Themelore. KKS mund të pranojë donacione, pasuri, trashëgimi ose uzufukt që i vlejnjë qëllimeve të Shoqatës. KKS duhet të përcaktojë një fond rezervë, sasinë dhe destinacionin e të cilit e vendos Këshilli Drejtues".

[26] Neni 4/c i Ligjit Nr.87, datë/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar me Ligjin 108/2020.

<p>MBLEDHJA E FONDEVE PËRMES FAQES SË INTERNETIT</p>		<p>4. A konsiderohet shitja e objekteve si bamirësi apo e ardhur nga aktiviteti ekonomik dhe, për rrjedhojë, a i nënshtrohet tatim/taksave?</p> <p>5. A konsiderohet shitja e mallrave të dhuruar si bamirësi apo e ardhur nga aktiviteti ekonomik?</p>	<p>bamirësi është e përjashtuar nga TVSH[27]. Nëse shitja e biletave kryhet nëpërmjet një pale të tretë, ky shitës mund të shërbejë si komisioner sipas neneve 935-944 të Kodit Civil, i ndryshuar, dhe i faturon OJF-së shërbimin e shitjes së biletave. Ndërsa biletat shiten nga kjo palë e tretë dhe fondi i mbledhur i kalohet i plotë OJF-së; kjo e fundit i paguan palës së tretë vetëm çmimin e shërbimit të faturuar të shitjes së biletave.</p> <p>4. Duke u bazuar në marrëveshjet me komunitetet fetare në Shqipëri, sendet të cilat janë në pronësi të tyre dhe që përdoren pa qëllim fitimi, por për arsye humanitare dhe bamirëse përjashtohen nga sistemi i taksave. Nëse sendet shiten nga komunitetet fetare, të ardhurat nuk duhet të taten me tatim mbi të ardhurat nëse ato përdoren për veprimtari të regjistruara të komuniteteve.</p> <p>5. Nëse sendet e paluajtshme shiten nga komunitetet fetare, ligji parashikon shprehimisht se ato janë të përjashtuara nga taksa vendore për kalimin e pasurisë së paluajtshme, por paguajnë pjesën që i takon agjentit të taksave. Interpretohet që komunitetet fetare janë të përjashtuara edhe kur ua dhurojnë pasuritë e paluajtshme dhe ku përfitues të drejtpërdrejtë janë institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore[28]. Shitja e sendeve nga OJF për të siguruar të ardhura për veprimtarinë joekonomike jofitimprurëse konsiderohet si pjesë e veprimtarisë ekonomike jofitimprurëse të OJF. Ajo është e tatueshme në shkallën që është e tatueshme çdo veprimtari joekonomike jofitimprurëse e OJF-së, pra, është e tatueshme me tatim mbi të ardhurat nëse të ardhurat nuk</p>
--	--	---	--

[27] Ligj Nr.92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

[28] Neni 29 i Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE", i ndryshuar.

<p>MBLEDHJA E FONDEVE PËRMES FAQES SË INTERNETIT</p>		<p>6. Cilat rregulla për mbrojtjen e konsumatorit janë relevante dhe duhet të respektohen kur OJF-të organizojnë një event për mbledhjen e fondeve?</p>	<p>destinohen për veprimtarinë jofitimprurëse të regjistruar të organizatës[29]. Nëse të ardhurat nga shitja e mallrave përdoren për bamirësi, nuk ka rregullime ligjore të posaçme, por duhet mbajtur parasysh që bamirësia kualifikohet veprimtari joekonomike jofitimprurëse. Në veçanti, nëse sendet e paluajtshme shiten nga OJF, ligji parashikon shprehimisht se ato janë të përjashtuara nga taksa për kalimin e pasurisë së paluajtshme por pagujnë pjesën që i takon agjentit të taksave. Interpretohet që OJF janë të përjashtuara edhe kur ua dhurojnë pasuritë e paluajtshme dhe ku përfitues të drejtpërdrejtë janë institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore.</p> <p>6. Në lidhje me të drejtat e konsumatorit, Ligji Nr. 9902, datë 17.4.2008 "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve", i ndryshuar[30], është ligji i zbatueshëm edhe kur OJF-të organizojnë aktivitete për gjenerimin e të ardhurave. Ky ligj përkufizon se çfarë do konsiderohet 'konsumator' dhe parashikon se cilat janë të drejtat e tyre. Edhe vetë OJF-të konsiderohen si konsumatorë kur ato blejnë mallra dhe shërbime.</p>
<p>MBLEDHJA E FONDEVE PËRMES FAQES SË INTERNETIT</p>	<p>DHURIME NGA PAGAT[31]</p>	<p>1. A i lejojnë ligjet/rregulloret punëdhënësit të realizojë dhurime nga pagat? A ekziston një kërkesë formale që punëdhënësit të përmbushin këto kërkesa të punonjësve?</p>	<p>1. Kodi i Punës nuk ka një dispozitë në lidhje me këtë. Kodi i Punës e ndalon punëdhënësin që të mbajë pagesën e pagës nga punonjësi (në një masë të caktuar). Duke pasur parasysh sa më sipër, çdo shumë tjetër për t'u dhënë / mbajtur nga paga e punëmarrësit mund dhe duhet të dakordohet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit si pjesë e angazhimit të tyre të ndërsjelltë kontraktual[32].</p>

[29] Neni 40 i Ligjit "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar.

[30] Ligji Nr.9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar.

[31] Dhurimet jepen rregullisht për qëllime bamirësie nga punëdhënësi duke e zbritur shumën në fjalë drejtpërdrejt nga paga çdo muaj

[32] Ligj Nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë, i ndryshuar.

<p>MBLEDHJA E FONDEVE PËRMES FAQES SË INTERNETIT</p>	<p>DHURIMI I TRASHËGIMISË</p>	<p>1. A mund të përfitojnë OJF-të pronë me anë të trashëgimisë me testament?</p> <p>2. A përjashtohen OJF-të nga tatimi/taksat për dhurime të tilla?</p>	<p>1. Bazuar në Kodin Civil, i ndryshuar, OJF-të janë të lejuara të marrin dhurime si trashëgimi testamentare^[33], si çdo subjekt tjetër fizik apo juridik.</p> <p>2. Ka përjashtim nga Taksa për Kalim të Pasurisë së Paluajtshme (e cila kualifikohet si taksë vendore) tek OJF-të^[34]. Pasi titulli i pronësisë i kalon OJF-së, kjo e fundit është e detyruar të paguajë taksën vendore të pasurisë së paluajtshme përkatëse (pavarësisht llojit të pasurisë së paluajtshme). Komunitetet fetare përjashtohen nga taksa e pasurisë së paluajtshme ndërtesë (neni 22/dh i Ligjit 9632, date 30.10.2006, i ndryshuar). Duke u bazuar në marrëveshjet e komuniteteve fetare me shtetin Shqiptar, objektet që janë objekt trashëgimie përjashtohen nga tatim/taksat.</p>
<p>MBLEDHJA E FONDEVE PËRMES FAQES SË INTERNETIT</p>	<p>SPONSORIZIMI</p>	<p>1. A e përcakton legjislacioni sponsorizimin?</p>	<p>1. Legjislacioni Shqiptar bën një rregullim të veçantë të sponsorizimeve dhe përkufizon 'sponsorizimin' dhe 'sponsorizuesit'^[35]. Në Ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat ka dispozita ligjore në lidhje me të ardhurat e dhëna për sponsorizim. 3 % ose 5% (në varësi të aktiviteteve që sponsorizojnë – shih më poshtë për më shumë hollësi) e fitimit të tatueshëm para tatimit është shpenzim i zbritshëm për subjektet tregtare që sponsorizojnë aktivitete për qëllimet e përcaktuara në Ligjin për Sponsorizimet. Ka edhe një parashikim në Ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat në lidhje me shpenzimet e njohura për efekte të fitimit të tatueshëm (shih më poshtë), i cili nuk kualifikohet si sponsorizim.</p>

[33] Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar. Neni 26: "Persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji". Neni 386: "Trashëgimlënësi mund të ngarkojë trashëgimtarin ose trashëgimtarët e caktuar në testament që të kryejnë ndonjë veprim të dobishëm për shoqërinë ose ndonjë veprim tjetër, pa i dhënë të drejtë një personi të caktuar mbi këtë veprim (barrë). Kur trashëgimlënësi i lë me testament pasurinë shtetit, organeve të tij, ose enteve të ndryshëm, ka të drejtë të caktojë qëllimin për të cilin duhet të përdoret pasuria".

[34] Neni 29/1/c(ii) i Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar.

[35] Ligji Nr.7892, datë 21.12.1994 "Për Sponsorizimet". Neni 1: "Ky ligj rregullon mbështetjen me ndihma financiare e materiale, të quajtura në vijim "sponsorizime", të veprimtarive sociale e publike ku përfshihen veprimtaritë humanitare, kulturore e artistike, sportive, edukative, arsimore, ekologjike dhe vepra letrare, shkencore dhe enciklopedike si dhe botuesve të shtypit. Sponsorizimi me qëllime të përfitimit ekonomik nga sponsorizuesi është i ndaluar". Neni 3: "Sponsorizues në kuptim të këtij ligji janë vetëm subjektet që kanë cilësinë e tregtarit, qofshin këta persona fizikë ose juridikë, vendas, të huaj a me kapital të përbashkët. Subjektet buxhetore ose që përfitojnë financime buxhetore, nuk mund të jenë sponsorizues"

		2. A përjashtohen OJF-të nga tatim/taksat për të ardhurat nga sponsorimi?	2. OJF-të që marrin të ardhura në formë sponsorizimi apo dhurimi janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat bazuar në Ligjin për OJF-të. Ligji për Tatimin mbi të Ardhurat parashikon: "Nuk janë subjekt i tatimit mbi fitimin e korporatava "... ç) entitetet që ushtrojnë vetëm veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor apo edukativ, pasuria apo fitimi i të cilëve nuk përdoret për përfitimin e organizuesve apo anëtarëve të tyre;" [36].
MBLEDHJA E FONDEVE PËRMES FAQES SË INTERNETIT	MARKETIMI PËR QËLLIME BAMIRËSIE	1. A ka rregullime ligjore për mbrojtjen e konsumatorit në lidhje me marketimin e drejtpërdrejtë?	1. Në Shqipëri, ligji që siguron mbrojtjen e konsumatorit është Ligji Nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve". Ka rregulla për mbrojtjen nga marketimi i drejtpërdrejtë[37]: - Pëlqimi i marrësit të mesazheve të marketimit është parimi kryesor. - Ruajtja dhe përpunimi dhe mostransferimi i të dhënave personale bazuar në rregullimet ligjore është një parim tjetër i rëndësishëm. - Identifikimi i dërguesit është një parim tjetër i rëndësishëm. Në rast se nuk zbatohen këto rregulla ka kundravajtje administrative që variojnë nga 30.000 Lekë deri në 100.000 Lekë në varësi të shkeljes.

[36] Ligji Nr.29/2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat".

[37] Udhëzim Nr.14, datë 22.12.2011 "Për Përpunimin, Mbrojtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në Sektorin e Komunikimit Elektronik të Publikut". Neni 7 'Përdorimi i të dhënave për marketingun e drejtpërdrejtë'.



<p>MBLEDHJA E FONDEVE PËRMES FAQES SË INTERNETIT</p>	<p>REKLAMIMI SOCIAL</p>	<p>1. A ka kërkesa ligjore që transmetuesit të ofrojnë hapësirë falas për reklamat sociale?</p>	<p>1. Ligji Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar"[38], u jep të drejtën organeve të pushtetit dhe të administratës shtetërore vendore t'u kërkojnë ofruesve të shërbimit mediatic audioviziv (OSHMA-ve) të transmetojnë pa shpërblim komunikata të shkurtra, që paraqesin interes të veçantë për publikun e zonave ku ato transmetojnë dhe që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit, fatkeqësitë natyrore dhe njerëzore, rendin publik dhe sigurinë kombëtare.</p> <p>Rregullorja e Autoritetit të Mediave Audiovizuale AMA[39] përcakton mesazhet me interes të lartë për publikun e gjerë, të cilat OSHMA-të detyrohen t'i transmetojnë pa shpërblim. Të tilla konsiderohen "ato përmbajtje që synojnë të rrisin ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve, të ndryshojnë qëndrimet dhe sjelljet e tyre në çështje me ndjeshmëri sociale, si dhe që lidhen drejtpërdrejtë me mbrojtjen e shëndetit, fatkeqësitë natyrore dhe njerëzore, rendin publik dhe sigurinë kombëtare". Në këtë rregullore parashikohet gjithashtu që ofruesit e shërbimit mediatic audioviziv janë të detyruar të transmetojnë pa shpërblim "informacione, mesazhe e njoftime të organizatave të ndryshme jofitimprurëse për çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit, vetëm pas konfirmimit me shkrim nga AMA për llojin e mesazhit".</p> <p>Në Kodin e Etikës, Parimet Editoriale, dhe Standartet Profesionale të RTSH-së, miratuar me vendim të Këshilli Drejtues të RTSH-së (Vendimi Nr.72, nr.prot.3813, datë 23/11/2016), pika 19.3 parashikohet se RTSH ofron pa pagesë</p>
--	-------------------------	---	---

[38] Udhëzim Nr.14, datë 22.12.2011 "Për Përpunimin, Mbrojtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në Sektorin e Komunikimit Elektronik të Publikut". Neni 7 Përdorimi i të dhënave për marketingun e drejtpërdrejtë.

[39] <https://ama.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Rregullore-per-transmetimin-pa-shperblim-te-informacioneve-mesazheve-dhe-njoftimeve-me-interes-te-larte-per-publikun-e-gjere.pdf>

<p>MBLEDHJA E FONDEVE PËRMES FAQES SË INTERNETIT</p>	<p>REKLAMIMI SOCIAL</p>		<p>reklama për organizatat humanitare dhe thirrjet për ndihmë. Fondacionet dhe organizatat humanitare që nënshkruajnë një marrëveshje me RTSH kanë të drejtë për reklama pa pagesë[40].</p>
<p>MBLEDHJA E FONDEVE PËRMES FAQES SË INTERNETIT</p>	<p>POSTA DIREKTE</p>	<p>1. Cilat janë parimet dhe kërkesat e ruajtjes dhe përdorimit të të dhënave personale për qëllime marketimi të drejtpërdrejtë?</p>	<p>1. Për qëllime të dërgimit drejtpërdrejt të postës/email, zbatohen kërkesat ligjore të parashikuara nga legjislacioni për të dhënat personale, përfshirë por pa u kufizuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pëlqimi i marrësit të mesazheve të marketimit. - Ruajtja dhe përpunimi dhe mostransferimi i të dhënave personale bazuar në rregullimet ligjore, përfshirë mospërpunimi për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë.- Identifikimi i dërguesit.
<p>MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE E DREJTA E PRIVATËSISË</p>		<p>1. A njohin dhe mbrojnë ligjet/rregulloret të drejtën e privatësisë së OJF-ve, dhuruesve dhe përfituesve të tyre?</p> <p>2. A kanë detyrim OJF-të t'u raportojnë autoriteteve shtetërore emrat dhe/ose detaje të tjera të identifikimit/kontaktit të dhuruesve dhe përfituesve të tyre?</p>	<p>1. OJF-të e gëzojnë të drejtën e privatësisë, përveçse para organeve publike ku dhe për të cilat duhet të mbajnë të dhëna të plota dhe me identifikim të dhuruesve, etj.</p> <p>2. OJF-të kanë të drejtën për privatësi përveçse para organeve të përcaktuara me ligj, si organet tatimore, organet e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Kundër Financimit të Terrorizmit, dhe organet ligjzbatuese. Detyrimi për të raportuar për dhuruesit është i parashikuar në legjislacion, ndërsa detyrimi për përfituesit konkretë vjen si interpretim sa kohë që duhet të jenë transparente se cilët përfitues kanë përfituar nga financimi, për të shmangur financimin e terrorizmit. Në këtë paragraf nuk përfshihen detyrimet për raportime publike që kanë OJF-të në bazë të dispozitave të veçanta të legjislacionit shqiptar[41].</p>

[40] https://rtsh.s3.eu-central-1.amazonaws.com/4fe8d4a805a246d7a33ff6dc658036e9_202004071647.pdf

[41] Ligji Nr.80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse" dhe Ligji Nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Ligji Nr.25/2018 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

<p>MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE E DREJTA E PRIVATËSISË</p>		<p>3. A kanë detyrim OJF-të të publikojnë emrat dhe/ose detajet e tjera të identifikimit/kontaktit të dhuruesve ose përfituesve të tyre?</p> <p>4. Nëse detyrimet e raportimit/publikimit janë të aplikueshme për OJF-të, çfarë të dhënash personale duhet të raportohen/publikohen?</p> <p>5. Cilat janë rregullimet ligjore për ruajtjen e të dhënave personale (p.sh., a ka një afat kohor të përcaktuar me ligj)?</p> <p>6. A kanë të drejtë aksesit dhuruesit dhe përfituesit në lidhje me të dhënat e tyre që ruhen nga OJF-të dhe a mund të kërkojnë fshirjen e tyre?</p> <p>7. A ka lëshuar Autoriteti Mbikëqyrës i Mbrojtjes së të Dhënave në vendin tuaj një udhëzim për përpunimin e të dhënave personale të dhuruesve dhe marrësve të dhurimeve (p.sh. Udhëzues për mbledhjen e fondeve dhe mbrojtjen e të dhënave)?</p>	<p>3. Legjislacioni fiskal^[42] parashikon detyrimin e OJF-së për të mbajtur të dokumentuar në OJF dhe për të vënë në dispozicion të organeve përkatëse shtetërore emrat e dhuruesve dhe përfituesve.</p> <p>4. Detyrimet e raportimit janë të zbatueshme për OJF-të. Dhuruesit dhe përfituesit duhet të identifikohen me emër dhe numër personal për t'u mundësuar gjetja e tyre, nëse do të jetë jetë e nevojshme^[43].</p> <p>5. Legjislacioni parashikon rregullat për mbajtjen e të dhënave personale^[44] (përfshirë ruajtjen, mbajtjen, përpunimin, transferimin e të dhënave personale) nga kontrolluesit, si dhe të drejtën për akses, për të korrigjuar dhe për të fshirë të dhënat personale, dhe se çdo dokument, që ka edhe të dhëna personale. Cdo dokument, duhet të ruhet jo më shumë se 5 (pesë) vjet, sipas rregullit të përgjithshëm për ruajtjen e dokumentacionit.</p> <p>6. Dhuruesit apo përfituesit nuk kanë të drejtë për të aksesuar nga OJF-të të dhënat që janë mbajtur për ta dhe OJF-të nuk kanë detyrim ligjor për t'i dhënë ato, përveçse kur është marrë pëlqimi paraprak me shkrim nga subjekti i të dhënave personale. Megjithatë, këto mund të jenë objekt rregullimi kontraktual.</p> <p>7. Nuk ka rregullore specifike për sa i përket përpunimit të të dhënave personale të dhuruesve apo marrësve të dhurimit, përveç "përpunimit të të dhënave nga organizatat jofitimprurëse politike, filozofike, fetare ose sindikaliste, për qëllime të veprimtarisë së tyre të ligjshme, vetëm për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë, që kanë lidhje me veprimtarinë e tyre. Këto të dhëna nuk</p>
---	--	--	--

[42] Udhëzim Nr. 19, datë 9.7.2019 "Për Mbikëqyrjen e Organizatave Jofitimprurëse në Funkcion të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit"; Udhëzim Nr.16, datë 16.2. 2009 Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe për të Luftuar Financimin e Terrorizmit në Sistemin e Tatim-Taksave"

[43] Këto të përcaktuara në udhëzimet e mësipërme.

[44] Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

<p>MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE E DREJTA E PRIVATËSISË</p>			<p>u bëhen të ditura një pale të tretë, pa pëlqimin e subjektit të të dhënave, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj”[45].</p>
<p>NGRITJA E FONDEVE NDËRKUFITARE</p>		<p>1. A lejohen OJF-të me ligj/rregullore të marrin, përdorin dhe shpërndajnë lirisht fonde përtej kufijve?</p> <p>2. Nëse jo, si i kufizon legjislacioni dhurimet ndërkufitare?[46]</p> <p>3. A garantojnë ligjet/rregulloret trajtim të barabartë tatimor për dhurimet ndërkufitare dhe vendase?</p>	<p>1. OJF-të mund të marrin fonde, dhurime/donacione nga çdo person privat apo publik, shqiptar apo i huaj.</p> <p>2. Financimi ndërkufitar nuk është i ndaluar.</p> <p>3. Legjislacioni shqiptar parashikon trajtim të barabartë tatimor lidhur me financimin ndërkufitar të OJF-ve.</p>
<p>TATIMI</p>	<p>TATIMI I DHURIMEVE</p>	<p>1. A përjashtohen dhurimet monetare dhe në natyrë nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave?</p> <p>2. Cili është trajtimi i TVSH-së për furnizimin e dhurimeve në natyrë (p.sh. dhurimet ushqimore)?</p> <p>3. Si trajtohet TVSH-ja për blerje e mallrave/shërbimeve të financuara nga të ardhurat nga dhurimet?</p>	<p>1. Dhurimet monetare dhe në natyrë për OJF-të janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat[47].</p> <p>2. Dhurimet e mallrave, përfshirë por pa u kufizuar në dhurimet e ushqimeve, për individët në nevojë e për qëllime bamirësie janë të përjashtuara nga TVSH.</p> <p>3. Shitja e mallrave / shërbimeve të financuara nga dhurimet për OJF-të konsiderohet veprimtari ekonomike jofitimprurëse dhe është subjekt i regjimit tatimor të zbatueshëm për këtë veprimtari: janë subjekt i TVSH kur OJF është tatimpagues i TVSH / i</p>

[45] Ligj Nr.9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Neni 7 ‘Përpunimi i të dhënave sensitive’.

[46] Shembujt përfshijnë, ndërmjet të tjerave, ndalime të financimit ndërkombëtar, kufizime të financimit ndërkombëtar për disa lloj aktivitete, ndalime të marrjes së fondeve ndërkombëtare nga dhurues të veçantë, kërkesa për të informuar organet shtetërore përgjegjëse mbi përfitimin e financimit ndërkombëtar, kërkesa për të qenë “I lejueshëm” për të përfituar fonde ndërkombëtare përmes një procedure të veçantë, kërkesa për të përfituar fonde ndërkombëtare përmes llogarive të veçanta bankare, apo kanalizimi i tyre përmes fondit të centralizuar qeveritar, bankës apo organeve të tjera shtetërore, etj.

[47] Neni 40 i Ligjit Nr.8799 datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar.

TATIMI			<p>regjistruar për përgjegjësinë tatimore të TVSH (përveçse kur shiten mallra apo shërbime të përjashtuara nga TVSH) dhe nuk janë subjekt i tatim fitimit nëse të ardhurat nuk shpërndahen por përdoren për mbështetjen e aktivitetit joekonomik jofitimprurës të OJF-ve, me kusht që aktiviteti jofitimprurës të mbizotërojë ndaj aktivitetit ekonomik dhe totali i të ardhurave vjetore nga aktiviteti ekonomik nuk duhet të jetë më i lartë se 20%^[48].</p> <p>Blerja e mallrave dhe shërbimeve me të ardhurat nga dhurimet për OJF-të është subjekt i TVSH (përveçse kur blihen mallra apo shërbime furnizimi i të cilave është i përjashtuar nga TVSH).</p>
TATIMI	PËRFITIMET TATIMORE PËR DHURUESIT	<p>1. A ka ndonjë përfitim tatimor për dhuruesit (kompani dhe individë)? Nëse po, cilat lloje të përfitimeve tatimore janë të zbatueshme për dhuruesit (p.sh., kreditimi tatimor, zbritja tatimore, etj.)?</p>	<p>1. Kuadri ligjor Shqiptar nuk parashikon përfitime tatimore për dhuruesit individë.</p> <p>Përsa i përket përfitimeve tatimore për dhuruesit subjekte që kanë cilësinë e tregtarit (sponsorizues në kuptim të Ligjit për Sponsorizimet), këto janë rregulluar me ligj nga shteti shqiptar. Ligji në fuqi për Tatimin mbi të Ardhurat parashikon për shpenzime të zbritshme për dhuruesit tatimpagues të tatim fitimit që sponsorizojnë për efekte të llogaritjes së fitimit të tatueshëm (shih më sipër tek seksioni i sponsorizimeve). Legjislacioni shqiptar ka vendosur një përqindje të caktuar në lidhje me masën që përfiton dhuruesi si shpenzim i zbritshëm nga të ardhurat e tij për llogaritjen e fitimit të tatueshëm: "Sponsorizuesi përfiton, për shumën e sponsorizuar këto lehtësi tatimore: Subjekteve, persona fizikë a juridikë që paguajnë tatim mbi fitimin sipas Ligjit për Tatimin mbi Fitimin, shuma e sponsorizuar u njihet si shpenzim i zbritshëm deri në masën 3 për qind të fitimit para tatimit. Subjekteve, personave fizikë a juridikë që paguajnë tatim mbi fitimin, shuma e sponsorizuar për botuesit e shtypit</p>

[48] VENDIM Nr. 953, datë 29.12.2014 "PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 92/2014, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" I NDRYSHUAR <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=9517>

TATIMI	PËRFITIMET TATIMORE PËR DHURUESIT	2. A i përcakton qartë legjislacioni OJF-të kualifikuese, përqindjen e dhurimit që kualifikohet për përfitim, shumën minimale apo çdo limit tjetër?	dhe botimet e veprat letrare, shkencore, enciklopedike, si dhe për veprimtaritë kulturore, artistike e sportive u njihet si shpenzim i zbritshëm deri në masën 5 (pesë) për qind të fitimit para tatimit. Këshilli i Ministrave përcakton kriteret dhe masat e sponsorizimit nga personat juridike publike[49]”.
			2. Legjislacioni shqiptar përcakton aktivitetet që kualifikohen për përfitime tatimore, si veprimtaritë sociale dhe publike që përfshijnë vepra humanitare, kulturore dhe artistike, sportive, arsimore, ekologjike dhe letrare, shkencore e enciklopedike si dhe botuesit e shtypit, të zbatuara nga institucionet, shoqatat dhe çdo person tjetër juridik.[50]. Neni 50 i Ligjit për Tatimin mbi të Ardhurat[51] parashikon: Nuk janë shpenzim i zbritshëm: "...p) shumat e sponsorizuara: i. që tejkalojnë masën 5 për qind të fitimit para tatimit për botuesit e shtypit dhe botimet e veprave letrare, shkencore, enciklopedike, si dhe për veprimtaritë kulturore apo artistike; ii. që tejkalojnë masën 5 për qind të fitimit para tatimit për veprimtaritë sportive. Shumat e sponsorizuara, brenda kufirit të mësipërm për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të organizatave sportive të njohura nga legjislacioni në fuqi i fushës, për efekt të përlogaritjes së tatimit mbi fitimin e periudhës tatimore, janë të zbritshme sa trefishi i vlerës së shumës së sponsorizuar. Mbartja e tyre në periudhat tatimore të ardhshme nuk lejohet. Kjo zbritje lejohet pas lëshimit të "Autorizimit të sponsorizimit" nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve sipas procedurave të parashikuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

[49] Ligj Nr.7892, datë 21.12.1994 "Për Sponsorizimet", i ndryshuar, Neni 5: "Sponsorizuesi përfiton, për shumën e sponsorizuar në fakt, këto lehtësi tatimore: a) Subjekteve, persona fizikë a juridikë që paguajnë tatim mbi fitimin sipas ligjit nr.7677, datë 3.3.1993 "Për tatimin mbi fitimin", shuma e sponsorizuar u njihet si shpenzim i zbritshëm deri në masën 3 për qind të fitimit para tatimit. b) (e shfuqizuar) c) Subjekteve, personave fizikë a juridikë që paguajnë tatim mbi fitimin sipas ligjit nr.7677, datë 3.3.1993 "Për tatimin mbi fitimin", shuma e sponsorizuar për botuesit e shtypit dhe botimet e veprat letrare, shkencore, enciklopedike, si dhe për veprimtaritë kulturore, artistike e sportive u njihet si shpenzim i zbritshëm deri në masën 5 (pesë) për qind të fitimit para tatimit. Këshilli i Ministrave përcakton kriteret dhe masat e sponsorizimit nga personat juridike publike".

[50] Po aty, neni 1

[51] Ligj Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

<p>TATIMI</p>	<p>PËRFITIMET TATIMORE PËR DHURUESIT</p>		<p>Kjo dispozitë zbatohet vetëm për entitetet sponsorizuese, të cilat realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milionë Lekë, iii. që tejkalojnë masën 3 për qind të fitimit para tatimit për sponsorizimet e veprimtarive të tjera, që nuk përfshihen në nëndarjet "i" dhe "ii" të kësaj shkronje;...</p>
<p>TRANSPARENCA, PËRGJEGJSHMËRI DHE MBIKËQYRJA</p>	<p>PËRFITIMET TATIMORE PËR DHURUESIT</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Cilat janë kërkesat për raportim të OJF-ve për të ardhurat nga aktivitetet e mbledhjes së fondeve? 2. A ka ndonjë kërkesë të veçantë apo është pjesë e kërkesave të përgjithshme të raportimit të OJF-ve? 3. A ka ndonjë kërkesë raportimi për dhuruesit (individë apo subjekte) për dhurimet që ata kanë bërë për OJF-të? 4. A ka bazë ligjore të shprehur për mbikëqyrjen dhe supervizimin e aktiviteteve për mbledhjen e fondeve dhe a është proporcionale? 5. Cili autoritet është përgjegjës për supervizimin e aktiviteteve për mbledhjen e fondeve? Cili është qëllimi i mandatit të tij dhe çfarë sanksionesh parashikon legjislacioni në rast të mosrespektimit të kërkesave ligjore për mbledhjen e fondeve? 	<ol style="list-style-type: none"> 1. OJF-të nuk përgatisin raporte të veçanta vetëm për dhurimet, por duhet të mbajnë çdo dokumentacion mbi dhurimet. 2. OJF-të kanë vetëm detyrimin e përgjithshëm për përgatitjen e raportit vjetor dhe të pasqyrave financiare. Organet tatimore kontrollojnë burimin e dhurimeve të marra nga OJF-të. 3. Shoqëritë tregtare dhuruese kanë detyrimin të kontabilizojnë dhe pasqyrojnë në pasqyra financiare dhurimet apo sponsorizimet për përfituesit përkatës, përfshirë edhe OJF-të (por nuk ka detyrime të shprehura për përgatitjen e raporteve të posaçme). Individët nuk raportojnë për dhurimet që bëjnë për OJF-të. 4. Nuk ka bazë ligjore të shprehur për mbikëqyrjen dhe supervizimin e aktiviteteve për mbledhjen e fondeve. 5. Nuk ka autoritet publik të ngarkuar me detyrën e mbikëqyrjes së aktiviteteve të mbledhjes së fondeve për OJF, përveç organeve tatimore të cilat për qëllime fiskale dhe për qëllime kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit kanë të drejtën të kontrollojnë veprimtrinë e OJF-ve mbi fondet e marra nga to. Organet tatimore kontrollojnë për qëllime fiskale edhe dhurimet apo sponsorizimet e bëra nga subjektet

<p>TRANSPARENCA, PËRGJEGJSHMËRIA DHE MBIKËQYRJA</p>	<p>PËRFITIMET TATIMORE PËR DHURUESIT</p>	<p>6. A kanë detyrim ligjor institucionet financiare (p.sh. bankat) t'u japin autoriteteve shtetërore informacion/raporte mbi operacionet financiare të OJF-ve? Nëse po, në çfarë kushtesh?</p>	<p>tregtare të cilat kërkojnë që dhurimet dhe sponsorizimet të jetë shpenzime të zbritshme për qëllime të llogaritjes së fitimit të tatueshëm. Nuk ka penalitet për mungesën e kontrollit të shprehur dhe sanksionet për qëllime fiskale nuk zbatohen për shkak të mungesës së dispozitave ligjore të shprehura ose ligjeve të veçanta, siç parashikohet në nenin 37 të Ligjit për Organizatat Jo-fitimprurëse.</p> <p>6. Bankat si operatorë të sektorit bankar kanë detyrimin t'i trajtojnë me kujdesin e duhur klientët OJF (vigjilencën përkatëse siç përcaktohet në Rregulloren e Bankës së Shqipërisë nr. 44/2009) për origjinën e financimeve të cilat kalojnë nëpërmjet sistemit bankar dhe ato nuk përgatisin raporte specifike për klientët OJF.</p>
<p>REGJISTRIMI, LICENSIMI DHE LEJA</p>	<p>PËRFITIMET TATIMORE PËR DHURUESIT</p>	<p>1. A ka ndonjë kërkesë për autorizim, licencim ose njoftim për aktivitetet e mbledhjes së fondeve?</p> <p>2. Nëse po, a janë të nevojshme dhe proporcionale kërkesat ekzistuese të autorizimit, licencimit apo njoftimit? Për shembull, a përjashtohet nga ky detyrim mbledhja e fondeve në shkallë të vogël?</p> <p>3. A parashikon legjislacioni një numër të qartë dhe të kufizuar arsyesh të justifikueshme për refuzimin e kërkesave për leje? A është e mundur të ankimohet kundër vendimit?</p>	<p>1. Nuk ka dispozita rregullatore të posaçme të shprehura për licenca, leje, etj., për aktivitetet për ngritjen e fondeve.</p>

Shtojca 1: Parimet e rregullimit dhe vetërregullimit statutor të ngritjes së fondeve

Ky informacion është marrë nga libraria e botimeve të Qendrës Evropiane për Ligjin e Organizatave Jofitimprurëse (ECNL), publikuar në vitin 2020.

PARIMET E RREGULLIMIT DHE VETËRREGULLIMIT STATUTOR TË NGRITJES SË FONDEVE

Cilat janë Parimet e Ngritjes së Fondeve?

Parimet e Ngritjes së Fondeve ofrojnë një pasqyrë globale të tendencave aktuale rreth rregullimit dhe vetërregullimit të ngritjes së fondeve dhe ofrojnë parime dhe rekomandime që adresojnë 7 fusha kryesore: liritë themelore; metodat e ngritjes së fondeve; mbrojtja e të dhënave dhe të drejtën e privatësisë; ngritja e fondeve ndërkufitare; tatimi; transparenca, llogaridhënia dhe mbikëqyrja; dhe regjistrimi, licensimi dhe dhënie e lejes. Këto parime bazohen në standardet ndërkombëtare, rajonale dhe në praktikat e vendit.

Cili është qëllimi i Parimeve të ngritjes së fondeve?

Parimet e ngritjes së fondeve synojnë të mbështesin përpjekjet për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për ngritjen e fondeve në mbarë globin. Ato shërbejnë si pikë referimi për të nxitur dhe lehtësuar dialogun e mëtejshëm midis OJF-ve dhe politikëbërësve rreth mënyrës se si të ndjekin një sistem të ekuilibruar të kuadrit ligjor, bashkërregullimit dhe vetërregullimit që lehtësojnë dhe mundësojnë aktivitetet e OJF-ve për ngritjen e fondeve.

PARIMET



GARANCITË THEMELORE

1. Shtetet garantojnë të drejtën e OJF-ve për të përfituar, marrë dhe përdorur burime, të cilat përfshijnë para 'cash', në natyrë dhe forma të tjera të burimeve financiare nga donatorë individualë dhe institucione donatorësh.
2. OJF-të lejohen të ngrenë fonde për çdo qëllim legjitim jofitimprurës.
3. OJF-të informohen dhe përfshihen në mënyrë aktive në zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e ligjeve dhe politikave që ndikojnë në ngritjen e fondeve.



METODAT E NGRITJES SË FONDEVE

1. Shtetet lejojnë dhe inkurajojnë përdorimin e gamës më të gjerë të mundshme të metodave të ngritjes së fondeve.
2. Aty ku ekzistojnë rregullore që ndikojnë në metodat e ngritjes së fondeve, shtetet sigurojnë që këto rregullore që ndikojnë tek metodat e ngritjes, të jenë të qarta, rreptësisht të nevojshme dhe proporcionale me interesat.
3. Legjislacioni lejon përdorimin e teknologjive të reja në ngritjen e fondeve.
4. Shtetet sigurojnë që ofruesit e shërbimeve financiare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve nuk i kufizojnë aktivitetet e ngritjes së fondeve nëpërmjet politikave dhe praktikave të tyre.
5. OJF-të dhe profesionistët e ngritjes së fondeve konsiderojnë iniciativa vetërregulluese dhe bashkërregulluese për të udhëhequr zbatimin e metodave të ndryshme të ngritjes së fondeve.



MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE E DREJTA E PRIVATËSISË

1. Shtetet njohin dhe garantojnë të drejtën e privatësisë së OJF-ve, donatorëve dhe përfituesve të tyre.
2. Kërkesat e raportimit, zbulimit të informacionit dhe mbikëqyrja shtetërore nuk cenojnë të drejtën për privatësinë e OJF-ve, donatorëve dhe përfituesve të tyre.
3. Mbledhja dhe përdorimi i të dhënave për qëllime të ngritjes së fondeve bazohet në dhënien paraprake të pëlqimit nga ana e donatorëve ekzistues dhe të mundshëm, si dhe të përfituesve ose në çdo bazë tjetër ligjore të disponueshme, siç është ekzistenca e një interesi legjitim.
4. Qëllimi i të dhënave personale të mbledhura dhe koha e ruajtjes së tyre është e kufizuar dhe në përpjesëtim me qëllimin specifik të ngritjes së fondeve.
5. Donatorët dhe përfituesit kanë të drejtë të aksesojnë informacionin rreth të dhënave të tyre të mbajtura nga OJF-të dhe mund të kërkojnë fshirjen e të dhënave në çdo kohë.



NGRITJA E FONDEVE NË NIVEL NDËRKUFITAR

1. Shtetet nuk vendosin kufizime ose procedura invazive për OJF-të për të marrë dhe përdorur fonde ndërkombëtare dhe për transferimin e fondeve vendase për OJF-të jashtë vendit.
2. Shtetet garantojnë trajtim të barabartë tatimor për donacionet ndërkufitare dhe vendase.

3. Organizatat ndërmjetësuese mund të ndihmojnë për të lehtësuar ngritjen e fondeve ndërkufitare.

4. OJF-të që marrin fonde ndërkombëtare nuk stigmatizohen, etiketohen si agjentë të huaj ose sulmohen në mediat publike, nga qeveria ose nga palë të treta.

5. Bankat njohin të drejtën e OJF-ve për të hapur llogari bankare dhe për të përdorur shërbimet bankare.



TATIMI

1. Shtetet ofrojnë regjim tatimor preferencial dhe përjashtime nga taksat për një gamë të gjerë OJF-sh.

2. Përfitimet tatimore ofrohen në mënyrë të paanshme dhe transparente, bazuar në kritere të qarta dhe objektive dhe nuk përdoren për të cenuar pavarësinë e shoqërisë civile.

3. Shtetet inkurajojnë filantropinë duke ofruar përfitime të konsiderueshme tatimore për donatorët

4. Shtetet krijojnë stimuj ose iniciativa të tjera, të tilla si përcaktimet e taksave dhe skemat e listës së pagave.

5. Procedura për të përfituar nga përjashtimi i taksave dhe stimujt tatimorë është e qartë, e thjeshtë dhe e shpejtë.



TRANSPARENCA, LLOGARIDHËNIA DHE MBIKËQYRJA

1. Çdo kërkesë raportimi dhe zbulim informacioni është në përpjesëtim me qëllimin legjitim, duke ndjekur një qasje të bazuar në rrezik dhe nuk përdoret për të stigmatizuar OJF-të bazuar tek donatorët e tyre.

2. Çdo mbikëqyrje është e drejtë, objektive dhe jodiskriminuese dhe nuk cënon pavarësinë e OJF-ve.

3. Përcaktohen qartësisht me ligj organet përgjegjëse për mbikëqyrjen, objektin e mbikëqyrjes, qëllimin dhe kufijtë e mandateve të organeve mbikëqyrëse.

4. Çdo sanksion i lidhur me ngritjen e fondeve është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe është mjeti më pak ndërhyrës për të përmbushur objektivin e dëshiruar.



REGJISTRIMI, LICENSIMI DHE LEJA

1. Shtetet sigurojnë që çdo kërkesë autorizimi, licensimi ose njoftimi për aktivitetet e ngritjes së fondeve është e nevojshme dhe është mjeti më pak ndërhyrës për të arritur objektivin e dëshiruar.

2. Shtetet sigurojnë që çdo kërkesë për autorizim, licensim ose njoftim për aktivitetet e ngritjes së fondeve të jetë proporcionale.
3. Procedurat janë të thjeshta, të shpejta, të lira dhe lehtësisht të zbatueshme nga të gjitha OJF-të që dëshirojnë të organizojnë një aktivitet për ngritjen e fondeve.
4. Legjislacioni parashikon një numër të qartë dhe të kufizuar arsyesh të justifikueshme për refuzimin e kërkesave për leje.
5. Shtetet dhe subjektet për ngritjen e fondeve, së bashku me aktorët e interesit përkatës, vlerësojnë nëse mekanizmat vetërregullues mund të plotësojnë ose zëvendësojnë kërkesat ekzistuese.

Për çfarë mund të përdoren parimet dhe rekomandimet e ngritjes së fondeve?

- Vlerësimin e legjislacionit ose rregulloreve ekzistuese ose të propozuara, të cilat ndikojnë në ngritjen e fondeve;
- Lehtësimin e diskutimeve rreth mënyrës sesi ligjet, rregulloret dhe praktikët ekzistuese mund të përmirësohen në kuadër të standardeve dhe praktikave të mira;
- Identifikimin e metodave të reja, novatore për ngritjen e fondeve;
- Zhvillimin e rekomandimeve për përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues për ngritjen e fondeve dhe filantropinë dhe mënyrën për nxitjen e donacioneve përmes modeleve novatore vetë/bashkërregulluese;
- Mbështetja e nismave të përkrahjes dhe sensibilizimit për të krijuar një mjedis të favorshëm për donacionet private brenda dhe ndërmjet vendeve.
- Kryerja e hulumtimeve të mëtejshme të mjedisit lokal brenda vendit për filantropi;
- Përkrahja dhe rritja e ndërgjegjësimit për garanci më të forta për filantropinë në dokumentet e politikave ndërkombëtare dhe rajonale.

Si u zhvilluan Parimet e Ngritjes së Fondeve?

Parimet e Ngritjes së Fondeve u zhvilluan nga Qendra Evropiane për Ligjin e Organizatave Jofitimprurëse (ECNL) dhe Qendra Ndërkombëtare për Ligjin Jofitimprurës (ICNL) me mbështetjen e një grupi kyç ekspertësh për ngritjen e fondeve. Dokumenti u pasurua më tej nga disa kërkime të kryera mbi tema të tilla si vetërregullimi, licensimi, lejet dhe procedurat e njoftimit për qëllime të ngritjes së fondeve, rregullimi i mbledhjes së fondeve digjitale, mbrojtja e të dhënave, etj. Versioni paraprak u nda me më shumë se 40 ekspertë kryesorë përmes një konsultimi në internet për të kërkuar të dhëna të mëtejshme dhe për të vërtetuar gjetjet.



PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



Adresa

Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati 10,
App. 71 / 73, PO BOX 2418/1
1010 Tiranë, Shqipëri



Email

partners@partnersalbania.org



Website

www.partnersalbania.org